



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha Raportuese	Prill 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Drita Rudi dhe Valbona Gashi

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Kulturë:

- Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga drejtoria dhe Komuna;
- Nga Sektori i kulturës dhe institucioneve varëse të DKRS së, është përgatitur raporti i punës për muajin mars;
- Janë vizituar degët e bibliotekave në fshatrat: Bardhosh, Koliq, Keqekollë, Llukar, Slivovë dhe Hajvali nga drejtoresha Saranda Bogujevci, dhe bashkëpunëtorët Ajete Shoshi, zyrtare e lartë për çështje juridike dhe Drita Rudi, zyrtare e lartë për Kulturë;
- Janë bërë përgatitjet për kremtimin e manifestimit “ Dita e dëshmorëve të Prishtinës”;
Janë kontaktuar dhe mbajtur takime me shoqatat e Veteranëve të Luftës, nga të cilët kemi marrë listat, fotot e dëshmorëve të Prishtinës – gjithsej 67 dëshmorë;
- Është kontaktuar menaxheri i orkestrës Rexho Mulliqi, për realizimin e programit muzikor në Akademinë Përkujtimore “Dita e dëshmorëve”;
- Arkivi i qytetit gjatë muajit prill ka vazhduar punën sipas planit në rregullimin e materialit arkivor, fondi “Avokatura Publike”, regjistrimin në mënyrë elektronike i librave amzë të shkollës së mesme “7 Shtatori”, dhe janë përgjigjur në 60 kërkesa të palëve lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre;

- Sa i përket çështjes gjinore, mbarëvajtja e përgjithshme e punës është realizuar me sukses, si takimet me palë, bashkëpunimi/konsultimet me organizata relevante vendore dhe ndërkombëtare, organizimi i takimeve, pjesëmarrje, planifikimi për aktivitete etj.;
- Takim me drejtorin e Drejtorisë së Pronës, z. Kukaj, lidhur me pranim-dorëzimin e materialit arkivor të Drejtorisë së Pronës;
- QKF, më 2 prill 2016, Kori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës është prezantuar në programin e organizuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë;
- Më 2 prill 2016, pjesëmarrje në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Librit në bibliotekën “Hivzi Sylejmani”;
- Më 12 prill 2016, pjesëmarrje në Festivalin e Valleve në Kishnicë;
- Përgatitjet për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Valleve në Zagreb, Kroaci.

Sport dhe Rini:

- Pas “Thirrjes për aplikim” për subvencionim vjetor të klubeve sportive të komunës së Prishtinës, të shpallur në muajin mars të këtij viti, është mbajtur takimi me komisionin e caktuar për shqyrtimin e këtyre kërkesave. Ky takim është mbajtur më 12 prill 2016, ku është vendosur që të mbështeten financiarisht klubet sportive të përgjegjshme, bazuar në politikat programore që mban sektori ynë;
- Në periudhën mars-prill 2016, kemi pranuar kërkesa për regjistrim nga tri klube sportive të notit, të cilat janë: klub i notit “Nemo Op”, shkolla e notit “Zenit”, si dhe klubi i sporteve të ujit “H2O”, të cilat pas kompletimit të dokumenteve nga ana e tyre, bazuar në kriteret mbi regjistrim të klubeve publike sportive, janë pajisur me vendim, që nënkupton licencimin e tyre në DKRS.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Kulturë:

- 18 prilli – Dita Dëshmorëve;
- Dita Ndërkombëtare e Librit;
- 10 maj 2016, gara në ping pong, QKF me Gërçekun;
- 12 maj 2016, turnir futbollit, QKF me shkollën “Model”;
- 15 maj 2016, debat nga ambasadorët për Ditën e Familjes;
- 16 maj 2016, koncert i Korit të QKF-së;
- Teatri “Dodona” gjatë muajit prill 2016, planifikon t’i realizojë disa aktivitete;
- Shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave dhe skena e mbrëmjes;

- Provat e rregullta të shfaqjeve të repertorit, me qëllim të ruajtjes së nivelit artistik dhe teknik të shfaqjeve;
- Aktivitete të përditshme;
- Digjitalizimi i fotografive, shkrimeve të gazetave dhe materialeve të tjera të punës së teatrit gjatë periudhës 1986 – 2016;
- Planifikohen biseda dhe takime për aranzhimin e realizimit të një turneu disa ditë në Tiranë, për realizimin e tri shfaqjeve të skenës së mbrëmjes në formë shkëmbimi kulturor;
- Planifikohet shfaqja e Universitetit Amerikan - AUK - me titull “Shekspiri” .

Sport dhe Rini:

- 15 maj, Gjysmëmaratona Ndërkombëtare e Prishtinës;
- Thirrja për aplikim për subvencionim të OJQ-ve rinore;
- Pjesëmarrje në konferencën “Hartimi i Kornizës së Strategjisë Kombëtare të Sportit 2017-2021” organizuar nga MKRS, që mbahet më 12 maj 2016.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë

Kulturë:

- Më 18 prill, Dita e Dëshmorëve të komunës së Prishtinës, DKRS - Drita Rudi, zyrtare e lartë për kulturë, në bashkëpunim me Shoqatën e Veteranëve të Luftës, Naser Pacolli, shënoi manifestimin “Dita e dëshmorëve të Prishtinës”. Është bërë programi i një sërë aktivitetesh për shënimin e kësaj date.
Homazhe te varrezat e dëshmorëve, kryetari Shpend Ahmeti, i shoqëruar nga nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive komunale, bënë homazhe te Varrezat e dëshmorëve në lagjen “Velania”, si dhe bënë nderime te shtatorja e heroit Zajir Pajaziti, si dhe në fshatrat Makoc dhe Mramor.
U organizua dhurim i gjakut në sheshin “Zahir Pajaziti” .
Akademia përkujtimore u mbajt në Sallën e kuqe. Intonimi i Himnit, realizuar nga orkestra “Rexho Mulliqi” dhe solisti Luan Durmishi. Në emër të Shoqatës folën përfaqësuesi i familjeve të dëshmorëve z. Valon Osmani, bashkëluftëtarë dhe ministri i Diasporës, ndërsa në emër të Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti. Në vazhdim u organizua edhe pjesa artistike, ku performuan orkestra “Rexho Mulliqi” me solistët Luan Durmishi dhe Sanije Matoshi;
- Kontakte dhe realizimi i takimeve me përfaqësuesit kulturorë nga Ambasadat amerikane dhe Ambasada e Austrisë;
- Drejtoresha Saranda Bogujevci, realizoi takime me përfaqësues të kulturë të Ambasadës së Amerikës dhe asaj të Austrisë;

- Së bashku me Grupin e grave asamblistë të Komunës së Prishtinës, vizitë në komunitete fetare, bazuar në planin e punës, vizitë në Kishën katolike. Gjatë vizitës u shqyrtuan mundësitë e bashkëpunimit, bazuar në nevojat e këtij komuniteti fetar;
- Koordinim i punëve për shënimin e Ditës së Dëshmorëve të Prishtinës, më 18 prill;
- Me udhëzim të drejtores, së bashku me znj. Mjellma Mahmutaj, kemi përcjellë aktivitetet në sheshin "Nëna Terezë", si dhe në bibliotekën "Hivzi Sulejmani", me rastin e shënimit të Ditës ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtave të Autorit, më 23 prill;
- Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Kulturës, kanë organizuar Koncert në Sallën e kuqe të Pallatit të Rinisë. Me këtë rast nga Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, është prezantuar Kori i Qendrës me këngë korale, me tematikë festive, kombëtare;
- Më 12 prill 2016, pjesëmarrje e Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës në Festivalin e Valleve në Kishnicë;
- Më 2 prill, biblioteka "Hivzi Sulejmani" mbajti manifestimin tradicional Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë e të Rinj, në bashkëpunim me Karvanin e shkrimtarëve. Dita Ndërkombëtare e Librit dhe e të Drejtave të Autorit;
- Më 22-23 prill, në sheshin "Nënë Tereza" u organizua aktiviteti tradicional, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, OJQ-të "Artpolis" dhe "Etea". Në këtë aktivitet biblioteka ka ndihmuar në rafte dhe libra, gjithashtu ka regjistruar pa pagesë të gjithë të interesuarit. Gjatë kësaj dite janë shpërblyer lexuesit më të dalluar të vitit;
- Bashkëpunimi me Këndin Amerikan, Biblioteka përkujtimore ka vazhduar edhe këtë vit bashkëpunimin me Këndin Amerikan, me qëllim të edukimit joformal, ligjërata në gjuhën angleze dhe nga fusha të tjera, si teknologjia informative, ekonomia, dizajni etj.;
- Kurs për mësimin e shkrim-leximit për gratë e paarsimuara. Ky aktivitet bëhet në bashkëpunim me Këndin Amerikan. Përveç mësimin të shkrim-leximit, ato marrin edhe mësim bazike të teknologjisë. Ky aktivitet bëhet në bashkëpunim me Këndin Amerikan. Përveç mësimin të shkrim-leximit, ato marrin edhe mësim bazike të teknologjisë;
- Fatime Mehmetaj prezantoi në Pejë projektin "INELI Ballkanas" para bibliotekarëve të Kosovës. Tema ishte "Trende të reja për një bibliotekë moderne", që zgjoi interesim tek të pranishmit. Gjatë kësaj jave ligjëroi ligjëruesja Aleksandra Kelly nga Biblioteka publike në New York. Ajo e vizitoi bibliotekën "Hivzi Sulejmani" dhe objektin e ri në bibliotekës në lagjen "Dardania";
- Më 27 prill ka filluar bartja e fondit librar dhe materialit tjetër për në objektin e ri në lagjen "Dardania". Kjo bartje do të vazhdojë edhe më tutje derisa të përfundojë i gjithë procesi;
- QKF është duke bërë përgatitjet për Koncertin e Korit, që do të organizohet më 4 maj 2016, në Sallën e kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sportit;
- Përgatitjet për Festivalin Ndërkombëtar të Valleve në Zagreb, Kroaci, përgatitjet për debatin për të drejtat e fëmijëve nga ambasadorët e rinj;
- 12 prill 2016, pjesëmarrje në Festivalin në Kishnicë, me karakter garues;
- Teatri "Dodona" gjatë muajit prill 2016 realizoi shfaqje të rregullta:

Në skenën e Teatrit të Kukullave:

- 2 prill, "Mustaqoshi larosh";
- 9 prill, "Goni trazovaçi";

- 6 prill, "Fustani pika-pika";
- 16 prill, "Picërraku";
- 19 prill, "Libri shumëngjyrësh";
- 23 prill, "Princesha Zobeidë";
- 27 prill, "Princi i vogël" - F. Kosovë;
- 30 prill, "Qeni që nuk dinte të lehë";

Skena e mbrëmjes:

- 5 dhe 21 prill, "Më fol për dashurinë";
 - 22 prill, në gjuhën angleze është dhënë shfaqja "Shekspiri", në bashkëpunim me Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK).
- Provat e rregullta përkitazi me mbajtjen e nivelit artistik të shfaqjeve të repertorit, realizohen para secilës shfaqje dhe aktivitete të përditshme;
 - Gjatë muajit prill, nga Sotiraq Gusho janë realizuar tri kukulla, me qëllim të modifikimit të shfaqjes "Peshkatori dhe peshku", në formë bashkëpunimi me Teatrin e Kukullave "Piro Xëci" Pogradec.

Sport dhe Rini:

- Më 23 prill 2016, Dita Ndërkombëtare e Librit.
Me rastin e 23 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Librit, Sektori për rini organizoi një debat me temën "Libri dhe kultura e leximit". Të ftuar në këtë panel ishin: Munish Hyseni, drejtor i bibliotekës "Hivzi Sylejmani"; Kismete Hyseni, poete; Avdullah Zeneli, botues; Xhevat Sylja, shkrimtar, si dhe nxënës dhe të rinj të komunës së Prishtinës.
Fillimisht panelistët mbajtën nga një fjalë hyrëse, mbi atë se cila është rëndësia e librit në shoqëri, sa duhet të lexojnë të rinjtë, çfarë duhet të lexohet dhe si duhet të kultivojmë shprehinë e leximit të librave në hovin e zhvillimit teknologjik. Më pas u zhvillua një debat produktiv, ku mësimitdhënësit dhe nxënësit shprehen opinionet e tyre lidhur me temën.
Nga diskutimi dy orësh, në mes tjerash dolën edhe këto konkluzione:

Të ketë me tepër investime në bibliotekat e kryeqytetit;

Mungesa e stafit në bibliotekat e shkollave;

Të ketë ekzemplar të mjaftueshëm për t'i plotësuar kërkesat e nxënësve;

Mungesa e botimeve/përkthimeve të reja;

Të gjenden forma të përkrahjes për të rinjtë e talentuar në shkrime;

Të organizohen orë letrare në kuadër të shkollave;

Të ketë organizime të tilla me të shpeshta, në të cilat fitet për librin;

Në fund të këtij aktiviteti, përfaqësuesit e bibliotekës ndan mirënjohje për lexuesit më të mirë dhe për të gjithë ata që kontribuuan për bibliotekën gjatë këtij viti.

- Turneu memorial i shahut “Mesut Gashi”, organizuar nga klubi i shahut “Prishtina” dhe i mbështetur financiarisht nga DKRS, turne ky i cili mbahet nën patronatin e Komunës së Prishtinës, u organizua në sallën e restorantit “Prishtina” (afër Stadiumit të Prishtinës) më 3 prill 2016. Në këtë turne morën pjesë rreth 100 garues vendorë, si dhe shahistë nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi etj.;
- Pjesëmarrje në Konferencën e parë për Sportin Shkollor në Kosovë, organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Sportit, si dhe Federata e Sportit Shkollor me drejtorinë komunale për Arsim, Kulturë, Rinë dhe Sport.
Në këtë konferencë u shpalos programi i punës së Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës, ku u prezantuan arritjet, sfidat dhe perspektivat.
Konferenca u përmbledh në dy sesione, në të cilat u diskutuan këto pika:
 - Roli i sportit shkollor në sportin e Kosovës;
 - Historiku i formimit të Federatës së Sportit Shkollor, plani katërvjeçar i zhvillimit të sportit në shkollat e Kosovës;
 - Strategjia dhe vizioni për të ardhmen, kuantiteti dhe kualiteti i sportit në shkolla;
 - Roli i komunave në organizimin e garave shkollore në nivel të komunave;
 - Fondi i orëve të sportit sot, qëllimi i avancimit të punës, barazimi i vlerave mentale me vlerat fizike;
 - Rëndësia e futjes së edukatës fizike në ciklin e ulët - çerdhe (punës profesionale të pedagogut të sportit), si dhe
 - Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të nivelit lokal dhe qendror (Federata e Sportit Shkollor) – Marrëveshje e përbashkët.
- Në muajin prill është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Forumit për Iniciativë Qytetare (FIQ) dhe Komunës së Prishtinës, për projektin “Ambasadorët e rinj”.
Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ), me financim nga “National Endowment for Democracy” (NED), ka filluar implementimin e projektit “Ambasadorët e rinj”, projekt ky i cili ka për synim të zhvillojë dhe të forcojë aktivizimin rinor. Me aktivitetet e parapara që konsistojnë në krijimin e grupeve joformale rinore, FIQ do të punojë ngushtë me të rinjtë e Prishtinës, duke iu dhënë atyre pronësinë në vendimmarrje gjatë realizimit të projektit. Në këtë rast Komuna e Prishtinës do të ofron përkrahje financiare në vlerë prej 2,000 Euro shtesë, të cilat barten te FIQ si bartës i projektit.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues

Kulturë:

- “Press Reader” (agjenci e lajmeve që mbështetë dhe është partner i “INELI Balkans-Future Librares” pjesë e së cilës ishte Fatime Mehmetaj) në periudhën mars, prill dhe maj ka ofruar qasje online pa limit dhe pa pagesë, në 3,000 gazeta dhe më shumë se 2.000 revista për bibliotekën “Hivzi Sulejmani”. Kjo dhuratë e çmuar për studentët dhe të gjithë të interesuarit është e postuar në faqen e Bibliotekës në Facebook;
- Me 27 prill ka filluar bartja e fondit librar dhe materialit tjetër për në objektin e ri në lagjen “Dardania”. Kjo bartje do të vazhdojë edhe më tutje në muajin prill derisa të përfundojë i gjithë procesi;

<https://www.facebook.com/Biblioteka-Hivzi-Sylejmani-Prishtin%C3%AB-794156514045919/>

dhe në Ueb -faqen e bibliotekës

www.biblioteka-pr.org (për momentin është duke u përpunuar)

- Kontakti për takime me ambasada;
 - Arkivi planifikon pjesëmarrjeje në një trajnim të organizuar nga Agjencia e Arkivave të Kosovës, i cili do të mbahet prej 02.06.2016 – 06.06.2016 (dy ditë) në kolegjin “Fama” në Prishtinë, ndërsa tri ditë tjera në Shqipëri. Ky trajnim mbahet çdo vit, për t’i përcjellë trendët ndërkombëtare të arkivistikës;
 - Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
 - Në bibliotekë vazhdon puna: klasifikimi dhe katalogimi i librit;
 - Regjistrimi i anëtarëve të rinj, huazimi i librit dhe lidhja e gazetave;
 - Leximi dhe komentimi i librit, vizatime nga përmbajtja e librit, lojëra logjike, punë dore etj.;
 - Postimi i materialeve dhe aktiviteteve në faqen e bibliotekës në web-faqe dhe Facebook;
 - Përgatitja e raporteve mujore;
- Disa nga aktivitetet e përmendura më sipër janë të përhershme dhe realizohen gjatë gjithë vitit.

Sport dhe Rini:

- Pas disa vërejtje të paraqitura nga drejtoresha, znj. Saranda Bogujevci, për Projektplanin e Veprimt Rinor Lokal 2016-2018, para prezantimit në Bordin e drejtorëve, respektivisht në Kuvendin e Komunës, me qëllim të miratimit të këtij plani janë bërë plotësimet e kërkuara;
- Takime me zyrtarët e sportit të MKRS-së si dhe të Federatës së Atletikës lidhur me parapërgatitjet për Gjysmëmaratonën Ndërkombëtare Prishtina 2016.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese 2016.

Sport dhe Rini:

- Në fund të muajit prill është bërë pagesa e 6 klubeve sportive, me vlerë totale 15,500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesave të klubeve sportive, të aprovuara nga komisioni, pritet të bëhet gjatë muajit maj.

5.1.2. Takimet me palë

Kulturë:

- Takim me palë, të cilët paraqiteshin në zyrë për të marrë ndonjë informacion rreth kërkesave për subvencionim, të interesuar për konkurs, subvencionim për botime, ekspozita, SHKA, organizime;
- DKRS-ja në vazhdimësi ka takime me qytetarë për t'u pajisur me pëlqime për mbajtjen e aktiviteteve;
- Takim me përfaqësuesen e korit të posaformuar të femrave "Zerina";
- Takime me disa prindër të interesuar për t'i regjistruar fëmijët në QKF.

Sport dhe Rini:

- Takime me përfaqësues të klubeve sportive të kryeqytetit për të diskutuar rreth nevojave dhe kërkesave të ndryshme në fushën sportit, përfshirë këtu edhe kërkesat nga klubet sportive rreth mbështetjes ose jofinanciare të projekteve të tyre;
- Takime me përfaqësues të OJQ-ve rinore, të cilat u informuan për mënyrën e ndarjes së fondeve gjatë vitit 2016, ku po ashtu u njoftuan për "Thirrjen për aplikim", që do të bëhet në muajin prill për subvencionim të OJQ-ve të ndryshme rinore.

Takimet me institucionet e tjera

Kulturë:

- Takime me përfaqësues të Ambasadës amerikane dhe asaj të Austrisë;
- Takime me kryetarin e Familjeve të Dëshmorëve, dega në Prishtinë, z. Naser Pacolli, me qëllim të organizimit të përbashkët të Ditës së Dëshmorëve;

- Takim i znj. Bogujevci me përfaqësues të “Save the Children”, lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit. Në këtë u takim u diskutua mbarëvajtja e Asamblesë komunale të fëmijëve të Prishtinës, fuqizimi i këtyre fëmijëve, si dhe gatishmëria e dy palëve për mbështetje të mëtutjeshme të fëmijëve asamblistë;
- Gjatë muajit prill janë mbajtur dy takime të Grupit punues për projektin “SoRi”, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe organizatës “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH”. Takimi i parë ishte konsultativ, ndërsa takimi i dytë ishte informues për ata të cilët nuk ishin pjesëmarrës në trajnim në Prevallë.
- Takime dhe konsultime të vazhdueshme me “Save the Children” Znj. Rebeka Qena, rreth organizimit të aktivitetit të përbashkët me Asamblenë e Fëmijëve për shënimin e Ditës së Familjes;
- Gjatë muajit prill janë mbajtur dy mbledhje të Grupit të Grave, propozimi për organizimin e aktivitetit të radhës, tani viti i tretë, me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”, si dhe mbledhja e dytë, njoftim lidhur me aktivitetet e organizuara gjatë muajit prill në lidhje me procesin e organizimit të aktivitetit të radhës, tani viti i tretë, me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”;
- Takim i rregullt dhe i Asamblesë Komunale të Fëmijëve të Prishtinës, si dhe diskutim rreth propozimeve për shënimin e 15 majit, Ditës së Familjes;
- Takime me zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, të Drejtorisë së Kulturës.

5.1.3. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

Sport dhe Rini:

- Takime me përfaqësues të bashkësive lokale, të cilët me kërkesë të banorëve të lagjeve të tyre kërkojnë ndërtim të hapësirave rekreative sportive, me qëllim të krijimit të kushteve infrastrukturore rekreative sportive më të mira për të rinjtë e tyre.

5.1.4. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

5.1.5. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

Kulturë:

- Pranimi i raporteve të lëndëve të subvencionuara të fazave paraprake;
- Njoftimi me shkrim i palëve për kërkesat e subvencionuara, njoftimi për refuzime dhe të aprovuara.

Sport dhe Rini:

- Në sektorin tonë gjatë muajit shkurt janë pranuar gjithsej 7 lëndë, ku të gjitha ishin kërkesa nga klubet dhe shoqatat sportive.

5.1.6. Takime të tjera

Kulturë:

- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Misioni i OSBE së në Kosovë . “Një ditë e imagjinuar” të ftuara nga Komuna znj. Drita Rudi dhe Mevlude Zejnullahu;
- Takime të rregullta pune në kuadër të aktiviteteve të shumta të Teatrit.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Kulturë:

- Vonesa e alokimit të mjeteve, vonesa për shpallje të konkurseve për aplikim të subvencioneve ka shkaktuar shumë pakënaqësi te palët, duke shtuar fluksin e vizitave në zyrën e Sektorit të Kulturës;
- Gjatë këtij muaji në bibliotekën “Hivzi Sylejmani” ka pasur interesim të madh për anëtarësime të reja, për huazim të librit dhe për përdorimin e sallave të leximit, në qendër dhe në të gjitha degët e bibliotekës;
- Numri i atyre që e vizitojnë bibliotekën sillet nga 100 - 150 në ditë;
- Teatri “Dodona” ka nevojë për mjete, për ta shtuar prodhimin me shfaqje të reja, rikthimin e shfaqjeve të vjetra të suksesshme, si dhe mbështetjen e udhëtimeve për shfaqjet që kanë vlerë, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur.

7. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

Kulturë:

- Mungesë e stafit, në veçanti për trashëgimi kulturore, financier dhe një punëtor administrativoteknik;
- Biblioteka “Hivzi Sylejmani”, angazhim maksimal për fillimin e punës në objektin e ri;
- Trajnime të stafit të bibliotekës për organizimin e fondit dhe hapësirave në objektin e ri dhe njohuri për shërbime të reja.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Kulturë:

- Organizimi i manifestimit, 18 prilli - Dita Dëshmorëve të Prishtinës;
- Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë e të Rinj (2 prill);

Aktiviteti realizohet nga biblioteka, me mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Prishtinës;

Do të bëhet prezantimi i shkrimtarit të njohur Rexhep Hoxha;

- Shpallja e rezultateve të Konkursit letrar 2016 dhe leximi i mesazhit, që këtë vit vjen nga Brazili;
- Java e bibliotekës në Kosovë (Biblioteka Kombëtare), ngjarja më me rëndësi e bibliotekave, ku do të ketë tema profesionale nga bibliotekaria, ekspozita të librit, donacione etj.
Në kuadër të kësaj Jave, Fatime Mehmetaj do të prezantojë programin “INELI BALKANS-Future Library”;
- Dita Ndërkombëtare e Librit dhe të Drejtave të Autorit (23 prill 2016);
Në bashkëpunim me OJQ-të “Artpolis”, “Etea” dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Biblioteka do të bëjë anëtarësim pa pagesë në sheshin “Nënë Tereza”, do të ndihmojë OJQ-të me libra;
- Përmirësimi e dizajnit të web-faqes së bibliotekës, <http://www.biblioteka-pr.org/>;
- Aktivitete çdo javë, në bashkëpunim me Këndin Amerikan, në degën “Përkujtimore”;
Aktivitete me fëmijë: komentim i librit, vizatime, punë dore, në degën “Përrallat”
- Në teatrin “Dodona” parashihen që gjatë muajit prill 2016 planifikohen të realizohen disa aktivitete;
- Shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave;
Shfaqje të rregullta nga skena e mbrëmjes;
Provat e rregullta të shfaqjeve të repertorit, me qëllim të ruajtjes së nivelit artistik dhe teknik të shfaqjeve;
- Aktivitete të përditshme për 30-vjetorin e Teatrit dhe Festivalin VI të Teatrove të Kukullave 2016;
- Planifikohen biseda dhe takime për aranzhimin e realizimit të një turneu disa dite në Tiranë, për realizimin e tri shfaqjeve të skenës së mbrëmjes në formë shkëmbimi kulturor.

Sport dhe Rini:

- Gjysmëmaratona Ndërkombëtare Prishtina 2016, e cila organizohet nga Federata Atletike e Kosovës, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, si dhe me MKRS-në, përkatësisht Departamentin e Sportit. Kjo ngjarje e madhe sportive, e cila ka karakter ndërkombëtar, mbahet më 15 maj 2016, që është edicioni i gjashtëmbëdhjetë me radhë;
- Konferenca “Hartimi i Kornizës së Strategjisë Kombëtare të Sportit 2017-2021”, organizuar nga MKRS, e cila mbahet më 12 maj 2016.

9. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

Kulturë:

REKAPITULIM: Në teatrin “Dodona” gjatë muajit mars 2016, janë realizuar **23 programe** të ndryshme (për fëmijë, për të rritur dhe programe mysafire).

